



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME Nr. 2 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 17/12/2018

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë.

Drejtuar: Shoqërisë “POWER INDUSTRIES” sh.p.k me NUIS L51706022H dhe me adresë: Bulevardi Gjergj Fishta, Qendra Alpas, Shkalla 2, Kati i 5, Apartamenti 14, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozim”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-95918-11-26-2018.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “ Blerje Autokullë”, afati: 10 (dhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 48, Date 03.12.2018.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “POWER INDUSTRIES” sh.p.k me NUIS L51706022H me ofertë 2.785.000 (dy milion e shtatëqindë e tetëdhjetë e pesë mijë) Leke pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “LIGUS” sh.p.k me NUIS L51523001S me ofertë 2.696.000 (dy milion e gjashtëqindë e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) Leke pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

“LIGUS” sh.p.k me NUIS L51523001S

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- a) Nuk plotëson pikën 2.3.5, të kapacitetit teknik ku thuhet se *Operatori Ekonomik duhet të disponoj ose të paraqesi kontratë bashkëpunimi me servis të specializuar për riparimin e mjeteve të transportit brenda afatit të garancisë. Për të vërtetuar këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë edhe foto të ambienteve të brendshme të reparteve të punës* pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar këtë pikë.
- b) Nuk plotëson pikën 2.3.6, të kapacitetit teknik ku thuhet se *Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për realizimin e kontratës, të*

vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezën e punës, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, si mëposhtë: 1(një) inxhinier mekanik, dega Transport"pasi nuk është paraqitur CV-ja, librezë e punës dhe nuk përputhet titulli i diplomës pasi e ka inxhinier mekanik teknolog.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Shoqërinë **“POWER INDUSTRIES” sh.p.k me NUIS L51706022H** me adresë Bulevardi Gjergj Fishta, Qendra Alpas, Shkalla 2, Kati i 5, Apartamenti 14, Tiranë, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **2.785.000** (dy milion e shtatëqindë e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH, **është identifikuar si ofertë e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, Rruga 5 Maji**, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 07.12.2018.

Ankesa: Nuk ka.

